



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:071306

Datë: 16.12.2024

Numri i dokumentit: 06604955

2022:071307

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: A.Q me numër personal dhe N.R me nr. personal të dy nga fsh. K. Shtime, të cilët me autorizim i përfaqëson i autorizuari Kushtrim Agushi, kundër të paditurës Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit me adresë Shtime, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Lulzim Muharremi nga Shtimja, me objekt të kontestit kompensimi e inflacionit në pagë, me vlerë të kontestit: 921,76 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik me datë 16/12/2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.Q dhe N.R kundër të paditurës Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit.
- II. DETYROHET e paditura Komuna Shtime- Drejtoria e Arsimit që paditësve:
 - A.Q në emër të shpërblimit të inflacionit në pagë, për periudhën kohore nga dt. 01.12.2020-21.11.2022 të ja kompensojë shumën prej: 460,06€ (katërqind e gjashtëdhjetë euro e gjashtë cent), me kamatë ligjore prej: 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë nga data: 08/04/2022 e deri në pagimin definitiv, në afatin prej 7 (Shtatë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm dhe paditësit
 - N.R, në emër të shpërblimit të inflacionit në pagë, për periudhën kohore nga dt. 01.09.2020-21.11.2022 të ja kompensojë shumën prej: 461,70€ (katërqind e gjashtëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej: 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë nga data: 08/04/2022 e deri në pagimin definitiv, në afatin prej 7 (Shtatë)

ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

- III. DETYROHET e paditura që paditësve A.Q dhe N t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej: 137,00 Euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit në gjykatë përmes të autorizuarit të tyre av. Ekrem Agushi nga Prishtina, më datë: 08/04/2022 kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e dëmit të shkaktuar nga inflacioni për periudhën kohore nga dt. 18.04.2017-31.12.2021, të gjitha me kamatë vjetore prej 8 %, duke filluar nga dita kur kërkesa është bërë e kërkueshme e deri në pagesën definitive. Në padi është theksuar se paditësit janë të punësuar te e paditura në marrëdhënie pune në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë (më tutje SHFMU) „Hasan Prishtina,, në fsh. ... K. Shtime në bazë të kontratës së punës dhe listës së pagave të paraqitura për vitet për të cilat ka kërkuar kompensimin. Po ashtu ka theksuar në padi se në bazë të kontratës kolektive të nënshkruar nga Ministria e Arsimit shkencës dhe Teknologjisë (më tutje MASHT-i) e paditura ka qenë e obliguar që mesatarja vjetore e përqindjes së inflacionit të përfshihet në pagën e paditëses (neni 35.10 i kontratës kolektive) ashtu që e paditura nuk e ka përmbushur këtë obligim me asnjë nga vitet e kërkuara si më lart. Me parashtrësën për precizimin e kërkesëpadiës të dt. 30.10.2024, përfaqësuesi i paditësve Kushtrim Agushi nga Prishtina, si dhe në shqyrtimin gjyqësor ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet padia dhe kërkesëpadija e paditësve në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësve të jau paguajë shpërblimin e inflacionit në pagë për periudhën nga dt., edhe atë për paditësin A.Q shumë prej 460,06€ periudha 01.12.2020-21.11.2022 dhe paditësin N.R shumë prej 461,7€ periudha 01.09.2020-21.11.2022 me kamatë ligjore prej: 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë nga data: 08/04/2022 e deri në pagimin definitiv, në afatin prej 7 (Shtatë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi dhe në shqyrtim gjyqësor, ka theksuar se nuk e konteston faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, po e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për shkak se MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e financave sipas kontratës

kolektive kanë pasur për detyrë që të angazhohen bashkërisht për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e këtyre shumave. Po ashtu e ka kundërshtuar kompensimin edhe për faktin se që nga data 17.04.2020 marrëveshja kolektive nuk është në fuqi si dhe ka theksuar se kërkesa e paditësit është përfshirë në parashkrim.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova: kontrate pune nr. protokoli ... e dt. ... per paditesin e pare, lista e pagave per muajin dhjetor 2020, kontrate pune nr. protokoli ... e dt. ... per paditesin e dyte, lista e pagave per muajin shtator 2020.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë punëtor në SHFMU „Hasan Prishtina,, në fsh. ... K. Shtime përkatësisht janë në marrëdhënie pune pranë të paditurës kjo u vërtetua edhe përmes kontratave të punës së paditësve.

Gjykata përmes Kontratave të punës dhe listës së pagave, vërtetoi faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe për punën e bërë paditësi A.Q ka marrë pagë neto në vlerë: 251,7 euro dhe paditësi N.R ka marrë pagë bazë 223,62 euro.

Vërtetimin si dhe formularët e lartcekur, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj andaj gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

Gjykata përmes kontratave të punës me numër të protokollit ... dt.... (për paditësin A.Q) dhe kontrata e punës me nr të protokollit: ... dt. ... (për N.R), ka vërtetuar faktin se e ekzistimit të marrëdhënies së punës e cila nuk ka qenë kontestuese as nga e paditura.

Gjykata përmes listave të pagës ka vërtetuar faktin se paditësit për periudhën kontestuese paga e tyre bazë ka qenë: 272,88€, të cilën pagë gjykata e ka marr për bazë me rastin e llogaritjes së lartësisë së kërkesëpadisë.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 respektivisht me nenin 48 të këtyre kontratave është përcaktuar se këto kontrata hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese. Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me Kontratën Kolektive të datës 22.01.2021, në nenin 35.10 thuhet “Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të përfshihet në pagë”, ku gjykata bazuar në listat e pagës nuk rezulton se shkalla e inflacionit është përfshirë në pagë, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadisë në lidhje me shkallën e inflacionit e ka bazuar në të dhëna zyrtare të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës të publikuara në faqen zyrtare elektronike.

Bazuar në të dhënat e marra nga publikimi nga Enti i Statistikave të Kosovës rezulton se shkalla apo mesatarja vjetore e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0,2% dhe për vitin 2021 ka qenë 3,4%, për vitin 2022 ka qenë 11.6%, andaj për paditësin e parë për vitin 2020 i takon shuma e kompensimit në vlerën prej 0.54€, për vitin 2021 shuma në vlerën prej 111.33€, për vitin 2022 periudha janar-21.11.2022 i takon shuma në vlerën prej 348.19€, ndërsa për paditësin e dytë për vitin 2020 i takon shuma në vlerën prej 2.18€, për vitin 2021 shuma në vlerën prej 111.33€, për vitin 2022 periudha janar-21.11.2022 i takon shuma në vlerën prej 348.19€.

Gjykata lidhur me pjesën aprovuese, duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratave Kolektive për periudhën sa ka qenë në fuqi, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësve është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësve t’ia paguaj shumat e specifikuar në pikën II. të dispozitivit, sa i përket llogaritjes së përqindjes së inflacionit gjykata e ka marr për bazë vitin paraprak ku e ka bërë llogaritjen për vitin pasues, kjo për faktin se sipas Kontratës Kolektive thuhet se duhet të merret për bazë shkalla mesatarja vjetore e inflacionit, kurse buxheti i Republikës së Kosovës miratohet në fund të çdo viti, për vitin pasues e në këto raste nuk mund të dihet përqindja mesatare e inflacionit vjetor e që do të kishte mundësi

të ndahet buxheti për këtë kategori e që vullnetarisht të kishte mundësi shkallën e inflacionit ta fut në pagë, andaj gjykata vlerëson se është dashur të merret për bazë shkallën e inflacionit për vitet paraprake.

Gjykata deri te ky qëndrim ka ardhur duke u bazuar edhe me nenin 2 të LMD-së autonomia e vullnetit ku thuhet “Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, ti rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre” që në rastin konkretë palët me vullnetin e tyre janë pajtuar që sa i përket çështjes së inflacionit duhet të përcillet, respektivisht të përfundoj viti kalendarik e tek atëherë të merret për bazë mesatarja.

Andaj meqenëse ashtu siç është rregulluar e paditura ka pasur detyrim paditësve t’ia përfshijë në pagë shkallën e inflacionit të cilën gjë nuk e ka bërë për periudhën kontestuese, në njërën anë kurse në anën tjetër edhe paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 22.01.2021 sa i përket mjeteve monetare në emër të shkallës së përqindjes së inflacionit dhe nenit 8 të LMD-së, ku thuhet se “Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, lidhur me nenin 245 të LMD-së ku thuhet “Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditësve.

Sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësës, për faktin se Qeveria nuk ka ndarë buxhet për këtë kategori, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA e institucioneve të arsimit të lart, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste respektivisht nuk ka vij buxhetore andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësit.

Gjykata morri për bazë edhe deklarimin e përfaqësuesit të palës së paditur në përgjigjeje në padi dhe në shqyrtim gjyqësor se kërkesat e paraqitura në padi janë të parashkruara por që një gjë të tillë gjykata nuk e morri për bazë ngase nga shiqimi i shkresave të lëndës del se afati i parashkrimit nuk i ka arritur këto kërkesa deri në momentin e paraqitjes së padisë. Përkatesisht

kërkesat për shtesën e inflacionit sipas kontratës kolektive përfshihen për periudhën kohore nga dt. 01.12.2020-21.11.2022, ndërsa padia është paraqitur në gjykatë më dt. 08.04.2022 gjë që vërtetohet nga vula e pranimit e SMIL në gjykatë.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjta janë pa ndikim në zgjidhjen e çështjes ndryshe përtej asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata bazuar në nenin 452 par 1 lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së dhe TOAK, e ka obliguar të paditurën që paditësve të jau paguaj shpenzimet e procedurës edhe atë për padi shumë prej 117,00€, për taksë gjyqësore 20,00€, ndërsa refuzohet kërkesa e paditësve që të kompensohen për përfaqësim në seancë në shumë prej 156,00€ sepse në seancë nuk janë përfaqësuar nga avokati i licencuar në OAK por nga përfaqësuesi i autorizuar, si dhe refuzohet kërkesa e paditësve që të kompensohen për parashtresën për precizim të padisë sepse kjo parashtresë nuk hyn në grupin e parashtresave për të cilat paguhet kompensimi.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 143 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

2022:071307 datë 16/12/2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.